



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.48, datë 18.10.2023

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT DHE NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË
NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “GODINË MULTIFUNKSIONALE 2 KAT, RADHIMË”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Gazmend Cekodhima, Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit dhe ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë multifunkionale 2 kat, Radhimë”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me zhvillues Z. Gazmend Cekodhima.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.21, datë 26.01.2021, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO RUXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

